

Sami  
Frashëri

VEPORA

BIBLIOTEKA

854-82  
F 86

3

# Biblioteka RILINDJA

---

Redaktor

*Nazmi Rrahmani*



854-82

F 86


# Sami Frashëri: VEPRA • 3

---


## FJALË TË URTA



**RILINDJA**  
Redaksia e botimeve  
Prishtinë  
1978









## „FJALËT E URTA” TË SAMI FRASHËRIT

*Samiu lindi në vitin 1850 dhe fill pas mbarimit të shkollës fillore të fshatit vazhdoi mësimet në gjimnazin e Janinës ku iu vu studimit të thellë të gjuhëve të lashta dhe atyre të reja. Ritmet e shpejta në përvetësimin e njohurive dhe provat e tij të para për të tre-guar origjinalitetin e vet u dhanë të kuptonin bashkëkohësve të tij se pas periudhës së akumulimit të dijenive shkencore dhe formimit të shprehive të domosdoshme për të hyrë në rrugën e kërkimit, forca e mendimit të tij origjinal do të lëshonte shkëndija dhe do të linte gjurmë që nuk do t'i shlyenin dot vitet e gjatë. Dhe me të vërtetë ndodhi ashtu: Gjatë 34 vjetëve të punës së tij produktive si shkencëtar dhe si shkrimtar, ai shkroi mbi 50 e ca vepra, disa prej të cilave në disa vëllime. (Për të pasur një ide për proporcionet e këtyre veprave dhe për punën e gjatë e këmbëngulëse të shkencëtarit e patriotit tonë të madh, mjafton të përmendet se vetëm „Fjalori historiko-geografik” në 6 vëllime ka 4830 faqe dhe se për ta përfunduar atë ai ka punuar për 12 vjet me radhë). Duke njohur trashëgimin e vyer të Samiut, njohësit e thellë të tij, mahniten me gjerësinë e interesave e me aftësitë e tij të mëdha dhe me gadishmërinë e mendimit për t’iu përgjigjur me vepra shkencore problemeve të ngutëshme të kohës.*

*Samiu njihet si romancier dhe dramaturg, si gjuhëtarë i madh dhe filozof, si përkthyes dhe pedagog,*

si autor i një sërë veprash shkencore për masat, si autor tekstesh për shkollën, si autor i manifestit të Rilindjes sonë kombëtare „Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet”, si politikan largpamës, si ideolog i Rilindjes sonë kombëtare.

Mjafton të marrësh në duar dhe të studjosh një nga veprat e pakta të tij të shkruara në gjuhën shqipe „Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhet”, që të ndjesh forcën e mendjes dhe të karakterit të këtij biri të madh që lindi kombi ynë; por për të pasur një përfytyrim të plotë e të saktë për rrugën e formimit të tij si shkencëtar i shquar dhe si ideolog i Rilindjes sonë, studimi i veprave të tij të shkruara në gjuhën shqipe është i pamjaftueshëm.

Një ndër veprat e tij, që njihet fare pakë, (vetëm nga rrethet e studjonjësve të Samiut dhe nga ata që zotërojnë turqishten) është edhe një përmbledhje fjalësh të urta, të cilën Samiu e botoi aty nga viti 1878 në serinë e botimeve „Biblioteka e xhepit”.

Po ta krahasojmë me veprat e tjera, „Emsal” (Fjalë të urta) nuk është ndonjë vepër voluminoze, por ajo ka një rëndësi të dorës së parë për të kuptuar burimet e formimit të Samiut si shkencëtar dhe si ideolog i Rilindjes sonë kombëtare, qëllimet dhe bindjet e tij, gjerësinë e interesave, qëndrimin e tij ndaj qarqeve drejtuese të kohës, ndaj kombeve të shtypur, ndaj shkencës dhe artit, ndaj arësimit dhe kulturës dhe rolit të tyre në zhvillimin shoqëror. Kjo vepër na ndihmon të kuptojmë më mirë e më thellë gjendjen shpirtërore të shkencëtarit të madh, i cili për shkak të urrejtjes së tij të shprehur hapur kundër monarkisë, për shkak të atdhedashurisë së tij të shprehur me zjarr nëpër faqet e gazetave dhe të revistave që ai drejtonte, kish fituar mërinë dhe urrejtjen e tiranëve që drejtonin fatet e perandorisë turke. Duke lexuar këtë vepër dhe duke sjellë nëpër mend momentet më të rëndësishme të jetës së tij, të duket se ai ka vendosur në të jetën e vet, një jetë të kaluar me punë të pasionuar e këmbëngulëse, një jetë të



kërcënuar vazhdimisht, një jetë të shkrirë në luftë e në përpjekje për të ringjallur kombin tonë të lashtë, një jetë që nuk i përfillte kërcënimet e tiranëve dhe vdekjen dhe që u shua në tavolinën e punës duke pasur rreth e qark dymbëdhjetë mijë vëllime librash të bibliotekës personale.

Në parathënien e veprës, të cilën Samiu e ka shkruar vetë, thuhet se këto fjalë të urta ishin botuar prej tij herë pas here në rubrikën „Andej këndeje” të gazetave „Sabah”, (Mëngjezi) dhe se atij i ishin lutur miqtë e dashamirët që t’i përmbledhte dhe t’i botonte në një vëllim të posaçëm. Samiu në këtë parathënie përmend, veç të tjerash, se „meqenëse është caktuar që të tilla të thëna i shërbejnë moralit më shumë se këshillimet dhe predikimet e bëra haptazi, nuk u lejua nga lexuesit që ato të humbasin duke u lënë në faqet e një gazete, jeta e së cilës është nga mëngjezi deri në mbrëmje...” Dhe më tej vazhdon: „Mbasi e di që do të ketë nga ata që dëshirojnë të dinë se ku i kam gjetur këto proverba dhe si i kam sendërtuar, po them nja dy fjalë mbi këtë pikë për të mënjeluar dyshimin. Sikundër nuk e kam bërë zakon asnjëherë të përvetësoj mendimin dhe punën e tjetrit, edhe për këto nuk mund të lëvdohem se të gjitha kanë lindur nga mendja ime. Këto mund t’i ndajë në tri pjesë: një pjesë e tyre janë të thënat e filozofëve dhe letrarëve të Perëndimit dhe të Lindjes, në ca prej të cilave është përmendur emri i të zotit dhe në ca të tjera, jo — ca nga proverbat janë rindërtuar në përgjasim të të thënave të filozofëve dhe letrarëve të Perëndimit duke ja përshtatur moralit tonë kombëtar. Dhe pjesa tjetër, janë thjeshtësisht prodhim i mendimit tim të shkurtër dhe kjo kap pothuajse gjysmën e të gjitha këtyre proverbave. Sidomos të tilla janë shumica e atyre, që u përgjigjen nevojave të kohës dhe të gjendjes sonë...” Po të kemi parasysh kohën në të cilën botohet vepra, kuptojmë thellë qëndrimin burrëror të Samiut si patriot e shkencëtar përparimtar. Kuptojmë mirë gjendjen e tij shpirtërore

dhe vështirësitë e mëdha, që duhej të kapërcente për të lënë atë trashëgim të vyer, që sjell gjer në ditët tona forcën e mendjes dhe të karakterit të tij. Duke ndërjerë gjatë studimit të kësaj veprë rrahjet e zemrës dhe hovet shpirtërore të Samiut, duke e ngulur vështrimin në ato anë të jetës ku ai ka drejtuar goditjet e tij më të fuqishme, ne kuptojmë se rilindasit tanë të mëdhenj, që luftuan për të drejtat e atdheut mu në qendër të Perandorisë turke, kaluan nëpër një rrugë shumë të vështirë dhe shpesh herë ju desh të luftonin kundër armiqve me vetë armët e tyre duke u kujdesur e duke qenë gjithnjë në roje për jetën e tyre.

Pa rënë në subjektivizëm dhe pa dashur të modernizojmë Samiun, përmbajtja e veprës të çon tek mendimi se përfshirja në vepër e fjalëve të urta që kundërshtojnë njera tjetrën nuk është vetëm rezultat i botëkuptimit të Samiut në formim e sipër dhe i mungesës së kohës për të seleksionuar për së dyti (meqenëse ai i pat botuar ato më parë në rubrikën „Andej-këndej” të gazetës „Sabah” dhe „Terxhumani Shark”), por edhe një formë e stërholluar për të çarë rrugën e mendimit të tij shkencor, për të mos i prerë rrugën botimit të veprave të tij në ato kushte kur „I sëmuri i Bosforit” duke qenë në pragun e greminës, kalonte çdo gjë në një cenzurë të rreptë.

Megjithë këto kontradikta që ka vepra, meqenëse nuk ruhet gjithmonë një pozitë e përcaktuar mirë, por jepen edhe ide që janë në kundërshtim të plotë me njera tjetrën, mund të thuhet me bindje se fryma e saj demokratike, simpatia e autorit për njerëzit e punës, për virtytet e tij të larta, për kombet e shtypura është një fakt i padiskutueshëm.

Duke e vendosur Samiun në kohën dhe në vendin e vet, duhet thënë se për shumë probleme që ngre në vepër mendimi i tij mbetet përparimtar për kohën e tij, kështu p.sh. mendimi i tij për femrën nuk i kapërren kufijtë e mendimit demokratik-borgjez dhe as që mund të ngrihet në kuptimin tonë, por po të